

20181402719

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR

### Neni 1

Në Kodin zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 40/2006, 136/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18 dhe 99/18), në nenin 71 pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7), si vijon:

"(7) Në llogarinë e transaksionit nga paragrafi 1 të këtij neni, mund të deponohen edhe mjete nga xhiro-llogaria bazë e partisë politike, si dhe nga xhiro-llogaritë e veçanta për mjetet e siguruara nëpërmjet kredisë. Partia politike mund të kryejë transfer nga llogaria e transaksionit nga paragrafi 1 i këtij neni në xhiro-llogarinë bazë të partisë."

Paragrafët (7), (8), (9), (10) dhe (11) bëhen paragrafë (8), (9), (10), (11) dhe (12).

### Neni 2

Në nenin 75-d paragrafët (1) dhe (2) ndryshohen si vijojnë:

"(1) Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve e deri në fillimin e fushatës zgjedhore, radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (portalet) nuk guxojnë të emitojnë, përkatësisht të publikojnë reklamim të paguar politik, përveç shpallje dhe njoftime për grumbullim të nënshkrimeve për përkrahje të kandidaturës së grupit të zgjedhësve.

(2) Shpalljet dhe njoftimet për grumbullim të nënshkrimeve për përkrahje të kandidaturës së grupit të zgjedhësve, shoqëritë tregtare radiodifuzive duhet t'i emitojnë vetëm në blloqe të shënuara reklamuese në korniza të kohës së lejuar për reklamim në një ore reale program të emituar në kohëzgjatje prej gjithsej 6 minutash, prej të cilave për një pjesëmarrës në fushatën zgjedhore mund të ndajnë më së shumti 2 minuta, me ç'rast porositi duhet të shënohet qartësisht."

### Neni 3

Në nenin 75-gj paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Gjatë fushatës zgjedhore edhe në ciklin e parë edhe në ciklin e dytë të votimit, radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet mund të emitojnë gjithsej 9 minuta kohë shitesë për reklamim në orë reale program të emituar ekskluzivisht të dedikuara për reklamim të paguar politik, prej të cilave për partitë politike në pushtet mund të ndajnë më së shumti katër minuta, për partitë politike në opozitë mund të ndajnë më së shumti katër minuta, për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë që nuk kanë grup të deputetëve dhe për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikën e Maqedonisë mund të ndajnë një minutë."

Në paragrafin (4) pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "ose faqe interneti."

Pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), si vijojnë:

"(6) Mediet elektronike (internet portalet), nëse sigurojnë reklamim të paguar politik për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, janë të obliguar që në afat prej tri ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, të regjistrohen në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Mediet elektronike (internet portalet) që nuk do të regjistrohen në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, nuk do të kenë të drejtë të shfrytëzojnë mjete financiare për reklamim të paguar politik, të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(7) Regjistri i medieve elektronike (internet portaleve) mbahet në bazë të kërkesës së parashtruar për regjistrim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, me shtojcë të gjendjes rrjedhëse të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se gjashtë muaj."

Paragrafët (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafët (8), (9) dhe (10).

Në paragrafin (7) që bëhet paragrafi (9) fjalët: “dhe mediet elektronike (internet portalet)” shlyhen, ndërsa pas fjalëve “shpallje të zgjedhjeve” pika shlyhet dhe shtohen fjalët: “kurse për mediet elektronike (internet portalet) çmimi për hapësirë të shfrytëzuar të internet portalit për reklamim të paguar politik të mos e tejkalojë çmimin mesatar të reklamimit të llogaritur në tre muajt e fundit para ditës së shpalljes së zgjedhjeve.”.

Pas paragrafit (8) që bëhet paragraf (10) shtohet paragrafi i ri (11), si vijon:

“(11) Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore porositës i reklamimit të paguar politik të radiodifuzerët dhe mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet) është i detyruar të dërgojë media plan për reklamim të paguar politik.”.

#### Neni 4

Neni 76-v ndryshohet si vijon:

“(1) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele është e obliguar ta ndjekë prezantimin zgjedhor mediatik dhe servisin programor të radiodifuzerëve, kurse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për media elektronike (internet portale), në Republikën e Maqedonisë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele është e obliguar nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të parashtrijë raporte javore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa gjatë kohës së fushatës zgjedhore raporte ditore dhe të njëjtat i publikon në ueb faqen e Agjencisë.

(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të mbajë raporte javore për mediet elektronike (internet portalet) të cilat i plotësojnë kushtet e këtij kodi, të cilat kanë të bëjnë me reklamim të paguar politik, kurse gjatë fushatës zgjedhore raporte ditore dhe të njëjtat i publikon në ueb faqen e Komisionit.

(4) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele është e obliguar në afat prej 48 orësh pas përcaktimit të kundërvajtjeve të dispozitave të këtij kodi, kundër radiodifuzerit i cili i ka shkelur dispozitat, të ngrejë procedurë për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(5) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar në afat prej 48 orësh pas konstatimit të shkeljeve të dispozitave të këtij kodi, kundër medias elektronike (internet portalit) që i ka shkelur dispozitat, të ngrejë procedurë për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(6) Gjykata kompetente është e obliguar me kërkesë për procedurë për kundërvajtje nga paragrafi (4) i këtij neni të vendosë në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(7) Kundër vendimit të gjykatës kompetente mund të paraqitet ankesë në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit.

(8) Gjykata e shkallës së dytë është e obliguar për ankesën të vendosë në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të ankesës.

(9) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, nëse konstaton shkelje të dispozitave për mbulim të balancuar të zgjedhjeve nga ana e Servisit Publik Radiodifuziv, do të parashtrijë propozim për ngritje të procedurës për shkarkim të drejtorit të Servisit Publik Radiodifuziv.

(10) Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele është e obliguar në afat prej 60 ditësh nga dita e miratimit të këtij Kodi të miratojë Metodologji për monitorim të prezantimit mediatik zgjedhor nëpërmjet serviseve programore të radios dhe televizionit, kurse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar në afat prej 60 ditësh nga dita e miratimit të këtij kodi të miratojë Metodologji për monitorim të prezantimit mediatik nëpërmjet medieve elektronike (portaleve), gjatë proceseve zgjedhore dhe të njëjtat i publikojnë në ueb faqet e veta.”.

#### Neni 5

Pas nenit 76-g shtohet nen i ri 76-d, si vijon:

“Neni 76-d

(1) Për plotësimin e obligimeve ligjore të radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike (portaleve) në pjesën e publikimit të reklamimit të paguar politik, mjete financiare sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, të cilat paguhen në llogari të veçantë të Ministrisë së Financave.

(2) Këto mjete janë të dedikuara ekskluzivisht për financim të radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike (portaleve) në pjesën e publikimit të reklamimit të paguar politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

(3) Nëse mjetet e miratuara janë më të mëdha nga shpenzimet e bëra reale në aspekt të paragrafit (2) të këtij neni, pjesën e mbetur të mjeteve Ministria e Financave është e detyruar ta kthejë në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(4) Ministria e Financave i paguan shpenzimet për reklamimin e paguar politik të publikuar në bazë të faturës së dërguar nga ana e radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike (portaleve). Shtojcë e faturës së dërguar është media plani dhe Raporti për shërbime të realizuara të vërtetuara krahas nga radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (portalet) edhe nga pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore.

(5) Ministria e Financave i paguan shpenzimet për reklamimin e paguar politik të publikuar të radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe medieve elektronike (portaleve), në ditën e 12 nga dita e fushatës zgjedhore dhe 10 ditë pas mbarimit të fushatës zgjedhore.”.

Neni 6

Në nenin 85-a paragrafi (1) pas fjalëve: “media të shtypit” shtohen fjalët: “dhe mediet elektronike (portalet elektronike)”.

Në paragrafin (3) pas fjalës “parashtrohet” shtohen fjalët “Ministria e Financave.”.

Neni 7

Neni 86 shlyhet.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.